

Ftesë për kontrollshëndetësor

Ne të kemi mbyllur takim për ty për kontroll shëndetësor tek motra medicinale, shiko letrën tjetër për kohën dhe vendin. Ty po të dërgohet kjo letër sepse ti je i posa ardhur në Suedi.

Qëllimi i kontrollit shëndetësor është për të shikuar gjendjen tënde shëndetësore në mënyrë që të kesh një shëndetë sa më të mirë. Ky kontroll shëndetësor përbëhet nga një bisedë rreth shëndetit tuaj dhe bërja e analizave, ti nuk ke nevojë të jeshë esëll (i pa ngrënë) për analiza. Ne po ashtu kemi rezervuar një përkthyes në gjuhën tuaj. Përkthyesi e ka detyrim të ruajë konfidencialitetin.

Kontrolli shëndetësor është një ofertë dhe ardhja në këtë kontroll është mbi bazën vullnetare. Ky kontroll shëndetësor është falas dhe zgjatë afërisht 1 orë. Nëse nuk ke mundësi apo nuk do të marrësh pjesë në këtë kontroll atëherë të lutemi, ose mbylle takimin për një ditë tjetër ose anulohet fare.

Rezultati i këtij kontrolli nuk ka asnjë efekt në mundësinë tënde për të marrë leje qëndrimi në Suedi. Agjensia e Migracionit nuk ka qasje fare në rezultatet e këtij kontrollimi.

Këto duhet të marrësh me vete në vizitë (nëse i ke): Kartë identiteti, LMA- karrtë, pasaportë ose kartën e lejës së qëndrimit. Nëse ke dokumente me vaksina të mëherëshme do ishte mirë që ti marrësh me vete.

Emrin e motrës medicinale me të cilën do të takohesh, datën dhe orën i gjenë në letrën tjetër. Aty po ashtu mund të gjeshtë adresën tonë dhe numrin tonë të telefonit.

Mirë se vjen!